



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA TIRANË**  
**INSPEKTORATI I MBROJTJES SË TERRITORIT**  
**DREJTORIA E BURIMEVE NJERËZORE DHE SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE**  
**SEKTORI I PROKURIMEVE**

Nr. \_\_\_\_\_ Prot

Tiranë \_\_\_\_\_.2024

**FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT (PARAPRAK)**

23.09.2024

Drejtuar: [Emri: "IT Gjergji Kompjuter" SHPK, Adresa: TIRANE Njesia Bashkiake nr.2, Rruga "Faik Konica", ndertesa nr.3, hyrja nr.7, Tirane, Shqiperi, NIPT: K81503063B]

**Lloji i procedurës së prokurimit: E hapur e thjeshtuar,**

Marrëveshje Kuadër - me një operator ekonomik ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara - me afat 12 muaj.

**Numri i referencës së procedurës /Lotit: REF-11281-06-26-2024**

**Objekti i kontratës / Marrëveshjes Kuadër:** "Blerje pajisje kancelarie për Inspektoratin e Mbrojtjes së Territorit, Bashkia Tiranë"

**Fondi limit: 1,689,127** (një milion e gjashtëqind e tetëdhjetë e nëntë mijë e njëqind e njëzetë e shtatë) leke pa TVSH

**Kohëzgjatja e kontratës/marrëveshjes kuadër ose afati për zbatimin e saj: 12**

dymbëdhjetë muaj nga data e nënshkrimit të marrëveshjes kuadër.

**Afatet e lëvrimit: brenda 30 (tridhjetë) ditëve kalendarike** nga data e nënshkrimit të kontratës.

Publikimet e mëparshme (nëse është rasti): Buletini i Njoftimeve Publike [1 KORRIK 2024] [NR.34]

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit:

oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në kosto

oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në çmim X

Me anë të këtij Njoftimi ju informojmë se, në këtë procedurë kanë marrë pjesë Ofertuesit e mëposhtëm me këto vlera përkatëse të ofruara:

1. **"Infosoft OFFICE" shpk**

J62426002Q

Emri i plotë i shoqërisë

Numri i NIPT-t

Vlera **1,254,497** (një milion e dyqind e pesëdhjetë e katër mijë e katërqind e nëntëdhjetë e shtatë) lekë pa TVSH

2. **"IT Gjergji Kompjuter" sh.p.k**

K81503063B

Emri i plotë i shoqërisë

Numri i NIPT-it

Vlera : **1,358,910** (një milion e treqind e pesëdhjetë e tetë mijë e nëntëqind e dhjetë) LEKË pa TVSH;

3. **“Marketing & Distribution” sh.p.k**  
*Emri i plotë i shoqërisë*

J72124001N  
*Numri i NIPT-it*

Vlera : 1,572,019 (një milion e pesëqind e shtatëdhjetë e dy mijë e nëntëmbëdhjetë) LEKË pa TVSH

4. **“LIBRARI DYRRAHU” sh.p.k**  
*Emri i plotë i shoqërisë*

L91418502J  
*Numri i NIPT-it*

Vlera : 1,670,660 (një milion e gjashtëqind e shtatëdhjetë mijë e gjashtëqind e gjashtëdhjetë) LEKË pa TVSH

Nga pjesëmarrësit janë skualifikuar Ofertuesit e mëposhtëm:

1. Oferta e paraqitur nga Operatori ekonomik **Infosoft OFFICE shpk** *Numri i NIPT-it* J62426002Q, Vlera e Ofertes pa TVSH: 1,254,497 LEKË;

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave në mbështetje të Nenit 92 të Ligjit ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 82 të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” ,I ndryshuar si dhe dokumentave të tenderit të miratuara, vijoi me shqyrtimin dhe vlerësimin e ofertës së paraqitur nga ky Operator Ekonomik, nga ku rezultoi si më poshtë:

AK në kriteret e veçanta të kualifikimit ka kërkuar si më poshtë cituar:

**2.3.3** *Operatori ekonomik duhet të paraqesë ditën e hapjes së ofertave ,në orën dhe vendin e caktuar në dokumentet e tenderit, nga jo më pak se një 1(një) kampion (mostër) për disa nga mallrat objekt prokurimi përkatësisht me nr.rendor. 22, 23, 57.*

*Mostrat e kërkuara duhet të kenë një etiketë të ngjitur, e cila do të përmbajë: mostër “emri i artikullit”, numrin rendor sipas ofertës së paraqitur, objektin dhe datën e zhvillimit të tenderit, emrin e ofertuesit, nënshkrimin dhe vulën e operatorit ekonomik ofertues.*

*Shënim: Me qëllim shqyrtimin e mostrave mbi plotesimin e specifikimeve teknike të kerkuara nga autoriteti kontraktor në DST, për artikullin nr.57 “Letër A4, 80 g/m2” operatori ekonomik duhet të paraqesë në SPE (Sistemin e Prokurimit Elektronik) Skedën teknike të certifikuar nga prodhuesi ose distributori i autorizuar, ku te jene te pasqyruara karakteristikat dhe specifikimet teknike te tij, e cila të përputhet me mostrën e paraqitur.*

*Në momentin e dorëzimit të mostrave nuk është i nevojshëm logimi por vetëm prezantimi i artikujve me qëllim shqyrtimin e mostrave mbi plotesimin e specifikimeve teknike të kerkuara nga autoriteti kontraktor në DST.*

Në përmbushje të kriterit me Nr.2.3.3, Operatori ekonomik “Infosoft OFFICE” shpk ka paraqitur mostrat në datë 11.09.2024 orën 09:00 afati i fundit i pranimit të ofertave dhe mostrave. Gjatë shqyrtimit të mostrave të paraqitura nga operatori ekonomik “Infosoft OFFICE” sh.p.k dhe konkretisht për artikullin “Letër A4, 80 g/m2” u konstatua se Rizma e paraqitur si mostër kishte amballazhim pa emer (no name) si dhe nuk kishte të dhëna mbi specifikimet e artikullit duke bërë të pamundur verifikimin nga ana jonë të përputhshmërisë

së mostrës me skedën teknike të paraqitur në sistem, nga ana e OE “Infosoft OFFICE” sh.p.k. në cilësinë e distributorit të autorizuar.

Kriteri i kualifikimi mbi paraqitjen e mostrave, është vendosur me qëllim verifikimin nëse këto produkte plotësojnë kërkesat dhe specifikimet teknike të përcaktuara në dokumentet e tenderit.

Autoriteti kontraktor, duke qenë se është përfituesi direkt i kontratës objekt-prokurimi, është në të drejtën e tij të garantohet se operatorët ekonomikë pjesëmarrës i plotësojnë kërkesat e cilësisë për produktet që do të ofrojnë e rrjedhimisht është e drejtë e këtij të fundit t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin mostrat e produkteve të cilat duhet të përmbushin të gjitha specifikimet teknike të parashikuara në dokumentet e tenderit.

Me qëllim përmbushjen e kriterit të sipërcituar ku ndër të tjera përcaktohet ....operatori ekonomik duhet të paraqesë në SPE (Sistemin e Prokurimit Elektronik) Skedën teknike të certifikuar nga prodhuesi ose distributori i autorizuar, ku të jete të pasqyruara karakteristikat dhe specifikimet teknike të tij, e cila të përputhet me mostrën e paraqitur.” operatori ekonomik ofertues ka detyrimin ligjor të provojë në përputhje me kërkesat e autoritetit kontraktor plotësimin e kriterëve të kërkuara në dokumentet e tenderit, si rrjedhojë është detyra e tij të vërtetojë përputhjen e artikullit të paraqitur si mostër me skedën teknike të paraqitur prej tij në sistem.

Nga sa më sipër Komisioni i vlerësimit të ofertave arrin në përfundimin se Produkti i paraqitur si mostër nuk përputhet me Skedën teknike, si rrjedhojë Kriteri i vecantë nr. **2.3.3 do të konsiderohet i paplotësuar.**

KVO gjykon, Kriteret kualifikuese të përcaktuara nga autoriteti kontraktor janë të detyrueshme për t’u përmbushur nga të gjithë ofertuesit ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi dhe operatorët ekonomikë janë të detyruar të paraqesin ofertat në përputhje me kërkesat në dokumentet e tenderit dhe në zbatim të LPP çdo ofertë e cila nuk është dorëzuar në përputhje me kërkesat në dokumentet e tenderit do të refuzohet.

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave nga shqyrtimi i kësaj oferte në mbështetje të pikës 3, të nenit 92, të Ligjit ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, pikës 2, neni 82 të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” ,I ndryshuar si dhe dokumentave të tenderit të miratuara, **e shpall të pavlefshme** këtë ofertë pasi nuk plotëson kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit.

2. Oferta e paraqitur nga Operatori ekonomik “LIBRARI DYRRAHU” sh.p.k, *me Numri i NIPT-t L91418502J*, Vlera e Ofertes pa TVSH: **1,670,660 LEKË**;

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave në mbështetje të pikës 3, Neni 92 të Ligjit Nr.162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, ( i ndryshuar), dhe të Neni 83 pikës 1 të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” si dhe dokumentave të tenderit të miratuara, vijoi me shqyrtimin dhe vlerësimin e ofertës së paraqitur nga ky Operator Ekonomik, nga ku rezultoi si mëposhtë: .

AK në kriteret e veçanta të kualifikimit ka kërkuar si më poshtë cituar:

## **2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT**

### **1. Ofertuesi duhet të paraqesë:**

*b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;*

**3.1.3 Autoriteti/enti kontraktor pranon pagesën e vlerës së sigurimit të ofertës nga ofertuesi edhe në formën:**

*i. garancisë bankare X*

*ose*

*ii. nga shoqëri sigurimi të licencuara nga autoritetet kompetente X*

**Në përmbushje të pikës së sipërcituar operatori ekonomik nuk ka paraqitur Sigurimin e kontratës në asnjë nga format e kërkuara nga Autoriteti Kontraktor.**

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave nga shqyrtimi i kësaj oferte në mbështetje të pikës 3, të nenit 92, të Ligjit ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”,(i ndryshuar) pikës 2, neni 82 të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” , i ndryshuar si dhe dokumentave të tenderit të miratuara, **shpall të pavlefshme** këtë ofertë pasi nuk plotëson kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit.

\* \* \*

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë “IT Gjergji Kompjuter” sh.p.k **Numri i NIPT-t** K81503063B, Adresa: TIRANE Njesia Bashkiake nr.2, Rruga "Faik Konica", ndertesa nr.3, hyrja nr.7, Tirane, Shqiperi se oferta e paraqitur me vlerë totale prej **1,358,910** (një milion e treqind e pesëdhjetë e tetë mijë e nëntëqind e dhjetë) LEKË pa TVSH; është identifikuar si fitues (paraparak) i procedurës së prokurimit.

Me publikimin e këtij njoftimi, fillojnë afatet e ankimit sipas përcaktimeve në nenin 110 të Ligjit Nr. 162/2020, datë 23.12.2020, “Për Prokurimin Publik”.

**TITULLARI I AUTORITETIT KONTRAKTOR**

**KRYEINSPEKTOR**

**Rigers Sheqeri**

Konceptoi:

Përgj. S.Pro: K.Haxhiaj

Miratoi:

Dr. D.SH.M.B.NJ: A. Branko

Kopje:3

Afati: ..... vjet